

**BAZA E NEVOJAVE PËR SKEMË TË RE TË AKREDITIMIT
TË TRUPAVE CERTIFIKUES PËR CERTIFIKIMIN E PRODUKTEVE TË NDËRTIMIT**

MIRATUAR NGA,
UD. DREJTOR I PËRGJITHSHËM I DAK-së
Irfan LIPOVICA

PËRMBAJTJA

1. FUSHA	3
2. REFERENCAT	3
3. PËRGJEGJËSITË	3
4. FJALORI DHE SHKURTESAT	3
4.1 Fjalori	3
4.2 Shkurtesat	3
5. PËRSHKRIMI I DOKUMENTIT: Baza e nevojave për skemë të re të akreditimit të trupave certifikues për certifikimin e produkteve të ndërtimit.....	3
6. ANEKSET	5
7. REGJISTRAT	5
8. HISTORIA.....	5

1. FUSHA

Ky dokument përshkruan politikën, procedurat dhe veprimet e ndërmarra për zgjerimin e aktiviteteve të DAK.

2. REFERENCAT

Rregullorja (KE) 765/2008;

EA-1/06 A-AB:2022 (Marrëveshja shumëpalëshe e EA. Kriteret për nënshkrim. Politika dhe procedura për zhvillim).

Standardi ISO/IEC 17011:2017, Vlerësimi i konformitetit - Kërkesat për trupat e akreditimit që akreditojnë trupat e vlerësimit të konformitetit, neni 4.6.3;

ISO/IEC 17065:2012 Vlerësimi i konformitetit - Kërkesat për trupat që certifikojnë produktet, proceset dhe shërbimet

EA-1/22 A-AB: 2023 (Procedura dhe kriteret e EA-së për vlerësimin e skemës së vlerësimit të konformitetit nga anëtarët e trupave të akreditimit të EA-së);

Ligji nr. 05/L-117 për Akreditim;

Ligji nr. 06/L-033 për produkte të ndërtimit;

Rregullorja (MTI) nr. 02/2018 e Këshillit Profesional

Strategjinë për zhvillim industrial dhe mbështetje të biznesit 2030

3. PËRGJEGJËSITË

Ky dokument zbatohet nga stafi i DAK, KT dhe trupat e certifikues për produkte të ndërtimit.

4. FJALORI DHE SHKURTESAT

4.1 Fjalori

Për qëllim të këtij dokumenti, aplikohen termat dhe përkufizimet e dhëna në standardin ISO/IEC 17011:2017.

4.2 Shkurtesat

EA	Bashkëpunimi Evropian për Akreditim
DAK	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës
KP	Këshilli Profesional
MLA me EA	Marrëveshja Shumëpalëshe me EA
DAK-PO-08	Politika për krijimin e skemave të reja të akreditimit
KT	Komiteti Teknik

5. PËRSHKRIMI I DOKUMENTIT: Baza e nevojave për skemë të re të akreditimit të trupave certifikues për certifikimin e produkteve të ndërtimit

Zhvillimi i skemës për akreditimin e trupave certifikuese për produktet e ndërtimit është iniciuar me Ligjin nr. 06/L-033 për produktet e ndërtimit, Strategjinë për zhvillim industrial dhe mbështetje të biznesit 2030, pika 5.2.2.4, të Departamentit të Industrisë (Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë) si dhe nevojat e tregut.

Duke qenë se DAK është anëtare e asociuar e EA-së dhe në një të ardhme të afërt planifikon të nënshkruajë MLA me EA, është përgjegjëse për zbatimin e dokumenteve të EA-së. Në këtë drejtim, DAK me qëllim të krijimit të skemës për akreditimin e trupave të certifikimit për produkte të ndërtimit duhet gjithashtu të konsiderojë kërkesat nga EA-1/06 A-AB:2022, neni 5(h) dhe NIVELI i MLA-së me EA i paraqitur në Aneksin 2 të këtij dokumenti.

Për më tepër, në Ligjin nr. 05/l – 117 për Akreditim, në nenin 7, fushat e aktivitetit të DAK-së janë si në vijim:

- 1.1. Akreditimi i laboratorëve testues dhe kalibrues;
- 1.2. Akreditimi i laboratorëve mjekësor;
- 1.3. Akreditimi i trupave inspektues;
- 1.4. Akreditimi i trupave për certifikimin e produkteve;
- 1.5. Akreditimi i trupave certifikues të sistemeve të menaxhimit (cilësisë, ambientit etj.);
- 1.6. Akreditimi i trupave certifikues të personelit; dhe
- 1.7. Akreditimi i trupave tjerë për vlerësimin e konformitetit.

Akreditimi mund të bëhet i detyrueshëm për kryerjen e aktiviteteve specifike për vlerësimin e konformitetit nëse është përcaktuar në një ligj apo rregullore specifike. Në Rregulloren e (KE) 765/2008, DAK merr parasysh gjithashtu politikën për krijimin e skemës së re të akreditimit DAK-PO-08.

Duke marrë parasysh Ligjin Nr. 06/L-033 për produktet e ndërtimit që është në fuqi si dhe Strategjinë për zhvillim industrial dhe mbështetje të biznesit 2030, DAK ka identifikuar disa trupa certifikues potencial që mund të paraqesin kërkesë për tu akreditues për fushë e produkteve të ndërtimit.

Për të krijuar skemën për akreditimin e trupave certifikues, DAK ka përgatitur Programin e Aktiviteteve, të paraqitur në Aneksin 1 të Politikës për krijimin e skemave të reja të akreditimit.

Duke përcaktuar skemën e kërkuar të akreditimit për trupat certifikuese të produkteve në përputhje me ISO/IEC 17065, DAK është mbështetur nga projekte të ndryshme. Në këtë drejtim DAK është mbështetur me trajnime per Standardin EN ISO/IEC 17065 për personelin e DAK-së, ekspertët, anëtarët e Këshillit Profesional dhe palët e interesit.

Këto trajnime janë realizuar me qëllim të përgatitjes së personelit të DAK-së, ekspertëve, anëtarëve të Këshillit Profesional dhe palëve të interesit për skemën e re të akreditimit. DAK do të vazhdojë të përmirësojë njohuritë e personelit, ekspertëve, anëtarëve të Këshillit Profesional dhe palëve të interesit sipas këtij Programi për zhvillimin e skemës për akreditimin e trupave certifikues për produktet e ndërtimit.

DAK do të bashkëpunojë me anëtarët e Komitetit Teknik (KT) për të krijuar skemën e re.

Në këtë fazë, DAK do të mbështetet nga anëtarët e Këshillit Profesional për të zbatuar politikën për krijimin e skemës së re të akreditimit DAK-PO-08, në përputhje me nenin 4 (1.4 dhe 1.5) të Rregullores (MTI) nr. 02/2018 të Këshillit Profesional dhe të krijojë këtë skemë të re.

6. ANEKSET

PO-08- F01 Aneksi 1 Programi i Aktiviteteve

PO-08- F02 Aneksi 2 dhe NIVELI i MLA-së

7. REGJISTRAT

Nuk aplikohen

8. HISTORIA

Data e botimit	Përgatitur nga	Përshkrim i ndryshimeve të aplikuar
04.04.2019	Ardiana Krrabaj	Dokument i ri
15.11.2019	Valmira Sejdiu	Rishikim i plotë bazuar në standardin ISO/IEC 17011:2017 dhe DAK-PM-01
20.11.2024	Jeton Aliu	Rishikim i pikës 2, 5 dhe 6